

STATUTI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Evolutivo Albania” sh.p.k.

Neni 1
Themelimi, Emërtimi, Ortakët

Sot, në Tiranë, më datë 08/07/2024 (dymijë e njëzetë e katër), në mbështetje të legjislacionit shqiptar, respektivisht Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, Ligjit 131/2015 “Për qendrën kombëtare të biznesit” dhe Kodit Civil, **ortakët:**

1. **Shoqëria "Evolutivo Sh.p.k."** me seli në Milano (MI) Via Bisceglie 76 CAP 20152 regjistruar në Dhomën e Tregtisë së Milano Monza Brianza Lodi - Zyra e Regjistrimit të Ndërmarrjeve me numër P.IVA dhe Kodi Fiskal 13244280965, përfaqësuar nga administratori i vetëm Z. Davide Antonio Castioni i lindur në Milano më 06 Mars 1974 me kod fiskal CSTDDN74C06F205U, banues në Cesano Boscone (MI) Via Amerigo Vespucci 13/B CAP 20090 dhe me kartë identiteti Nr. CA05448AS lëshuar nga komuna e Cesano Boscone më datë 29.01.2018;
2. **Neritan Zylyftari**, shtetas shqiptar, i lindur në Berat më 19.04.1985, banues në Tiranë në adresën Rruga Bill Klinton pallati 14, hyrja 1, identifikuar me dokumentin e kartës së identitetit me numër personal I50419078D;
3. **Eleni Kullira**, shtetase shqiptare, e lindur në Korce më 25/10/2000, banues në Tiranë në adresën Rruga Siri Kodra, identifikuar me dokumentin e kartës së identitetit me numër personal K06025088O;
4. **Denald Hushi**, shtetas shqiptar, i lindur në Manëz, Durrës më 08.08.1996, banues në Durrës në adresën Lagjia 14, Rruga Ali Beqja, Manëz, identifikuar me dokumentin e kartës së identitetit me numër personal J60808011C;

themelojnë, një Shoqëri Tregtare me emërtimin “Evolutivo Albania” si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të së drejtës shqiptare.



Neni 2 Objekti i veprimtarisë

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar Evolutivo Albania, do të zhvillojë aktivitetet me objektin e veprimtarisë si më poshtë:

A. Zhvillimin, prodhimin dhe tregtimin e produkteve ose shërbimeve inovative me vlerë të lartë teknologjike dhe më konkretisht:

1. ideimin, krijimin, ndërtimin dhe menaxhimin e aplikacioneve informatike inovative dhe me vlerë të lartë teknologjike;
2. ideimin, krijimin, ndërtimin dhe menaxhimin e faqeve dhe portaleve në "Web";
3. realizimin e faqeve në "Web", përpunimin grafik të zërit, teksteve, imazheve dhe videove;
4. krijimin dhe menaxhimin e "databazave" nëpërmjet rrjeteve telematike ose në faqe interneti; ofrimin për të tretët të çdo natyre dhe në çdo mënyrë të dhënave të përfshira në to; mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave të nevojshme për formimin e "databazave"; përpilimin, prodhimin, importimin, eksportimin, tregtimin në çdo formë ose marrjen me qira të bazave të të dhënave në përgjithësi, përfshirë dhe rrugë telematike;
5. prodhimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve dhe produkteve multimediale, si "online" ashtu edhe "offline";
6. ideimin, zhvillimin dhe shitjen e shërbimeve për privatë, ente publike dhe ndërmarrje edhe nëpërmjet rrugëve telematike;
7. realizimin e shërbimeve "online";
8. konsulencën, zhvillimin dhe realizimin e projekteve të "e-commerce" dhe "e-business";
9. realizimin e "newsletter" në formë letrare dhe online, katalogëve dixhitalë, marketingut të drejtpërdrejtë dhe email-eve të synuara;
10. kërkimin e aplikuar në fushën informatike/dixhitale për marrjen dhe optimizimin e proceseve/shërbimeve të reja;
11. konsulencën dhe ofrimin e shërbimeve për privatë, ndërmarrje, ente, shoqata në çështjet e përmendura më sipër;
12. blerjen, menaxhimin dhe dhënien në përdorim të sistemeve informatike, përpunimin e të dhënave të informatizuara edhe për llogari të të tretëve, si dhe studimin, realizimin, zhvillimin, shitjen, asistencën, mirëmbajtjen dhe personalizimin e sistemeve informatike, programeve software dhe hardware;
13. ofrimin e shërbimeve të "hosting", regjistrimin dhe aktivizimin e emrave të domain-it.

B. Shoqëria gjithashtu ka për objekt aktivitetet e mëposhtme që mund të kryejë direkt ose përmes pjesëmarrjes në shoqëri apo formacione të tjera tregtare:

1. ofrimin e shërbimeve të konsulencës për ndërmarrje, profesionistë dhe administrata publike në fushën e sigurisë së të dhënave, organizimit të burimeve hardëare dhe softëare dhe përputhshmërisë me legjislacionin në fuqi për privatësinë dhe sigurinë e të dhënave;
2. shërbime konsulence për proceset e biznesit dhe për dixhitalizimin e tyre; shoqëria për realizimin e objektit të saj mund të përdorë krijimin e softëare-eve dhe platformave online funksionale për ofrimin e shërbimeve të konsulencës dhe menaxhimin e bazave të të dhënave të ndërmarrjeve për prodhimin dhe përpunimin e informacionit të ofruara me licencë përdorimi ose me shitjen e kodit burimor përkatës;



3. patentimin e produkteve dhe proceseve të shpikura prej saj dhe të produkteve të ideuara ose të fituara nga të tretët, si dhe fitimin dhe tregtimin e patentave;
4. aktivitetin e trajnimit për ndërmarrjet dhe entet publike, organizimin e takimeve, seminareve, konferencave, kongreseve dhe aktiviteteve të tjera të lidhura me qëllimin e saj për promovimin dhe inkurajimin e aktiviteteve krijuese, duke prodhuar broshura, fletëpalosje dhe botime që ilustrjnë proceset teknike dhe teknologjike të produkteve të patentuara.

C. Shoqëria gjithashtu ka si objekt të veprimtarisë së saj edhe ofrimin e:

1. shërbimeve në menaxhimin e proceseve të biznesit të eksternalizuara (Business Process Outsourcing) për të ndihmuar ndërmarrjet të përmirësojnë efikasitetin e proceseve të tyre dhe të ulin kostot operative;
2. shërbimeve të cilat mund të përfshijnë analizën e proceseve të biznesit, përcaktimin e kërkesave, dizenjimin e proceseve, përzgjedhjen e furnitorëve, menaxhimin e kontratave dhe monitorimin e performancës, përveç menaxhimit të drejtpërdrejtë të këtyre proceseve, me personelin e vet ose me partnerë të jashtëm.

Ç. Shoqëria mund të kryejë të gjitha operacionet tregtare, industriale, të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme që konsiderohen të nevojshme ose të dobishme, të japë garanci edhe në favor të të tretëve, si dhe të marrë pjesë (zotërojë dhe tjetërsojë kuota) në shoqëri të tjera që kanë një objekt të ngjashëm me të.

Neni 3 Kohëzgjatja

3.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë ekonomike e shoqërisë Evolutivo Albania sh.p.k. është e pakufizuar.

3.2 Çdo ndryshim në lidhje me periudhën e aktivitetit mundet të bëhet vetëm nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë.

Neni 4 Selia, adresa elektronike, komunikimi, territori i veprimtarisë

4.1 Selia e Shoqërisë Tregtare Evolutivo Albania sh.p.k. është në Shqipëri, Tirane TIRANE Rruga Xhemal Tafaj, perballe me Gjimnazin Partizani 1015, Shqiperi.

4.2 Adresa e shoqërisë Evolutivo Albania shpk, për qëllime komunikimi elektronik është neritan.zylyftari@evolutivo.it dhe numri telefonik i saj është +355674000694

4.3 Për të gjitha komunikimet me shoqërinë, do të përdoret adresa e selisë së saj si dhe komunikimet me ortakët do të kryhen në adresat e përcaktuara në nenin 1 të këtij Statuti.

4.4 Për rastet kur parashikohet në këtë statut apo akte të tjera të shoqërisë, komunikimi nëpërmjet mjeteve të tjera të komunikimit, si telefon, celular faks, email etj, do të përdoren këto mjete komunikimi (numër telefoni/celulari, adresë emaili etj) të vëna në dispozicion nga ortakët dhe komunikimi mund të bëhet edhe nëpërmjet këtyre mjeteve. Në rast të ndryshimit të këtyre të dhënave (numr telefoni adresa) ortakët njoftojnë brenda 48 orëve shoqërinë për përditësimin e tyre.

4.5 Shoqëria duhet të krijojë një regjistër komunikimesh/protokollin të brendshëm dhe të jashtëm ku të regjistrohet i gjithë komunikimi i kryer për llogari të shoqërisë si me ortakët ashtu edhe me persona të tretë.

4.6 Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj. Për këtë, ajo mund të hapë edhe seli të tjera operative, filiale, përfaqësi dhe agjenci në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj, në përputhje me ligjet e vendeve ku ato hapen.

Neni 5 **Kapitali themeltar**

5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë me Përgjegjësi të kufizuar Evlutivo Albania shpk sh.p.k., është 100.000 Lekë, i ndarë në 4 (katër) kuota. Ortakët themelues, marrin në pronësi kuotën e tyre në kapitalin themeltar në përputhje me kontributin e secilit.

5.2 Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre si vijon:

- 1. Ortaku Themelues, Evlutivo shpk - zotëron një kuote, me vlerë të përgjithshme 93.000 lekë, që përbën 93% të kapitalit themeltar të shoqërisë;**
- 2. Ortaku Themelues Neritan Zylyftari - zotëron një kuotë, me vlerë të përgjithshme 3000 lekë, që përbën 3% të kapitalit themeltar të shoqërisë;**
- 3. Ortaku Themelues Eleni Kullira – zotëron një kuotë, me vlerë të përgjithshme 2000 lekë, që përbën 2% të kapitalit themeltar të shoqërisë;**
- 4. Ortaku Themelues Denald Hushi - zotëron një kuotë, me vlerë të përgjithshme 2000 lekë, që përbën 2% të kapitalit themeltar të shoqërisë;**

5.3 Pronësia mbi kuotat dhe veprimet me to regjistrohen në regjistrin që shoqëria mban për këtë qëllim.

5.4 Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë.

5.5 Ortaku i vlerëson kontributet në natyrë dhe i shpreh vlerat e tyre në para.

Neni 6 **Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit**

6.1 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anën e kontributeve në natyrë.

6.2 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

6.3 Nëse shoqëria ka nevojë për likujditete për financimin e veprimtarisë së saj, ortakët mund të bien dakord për dhënie hua shoqërisë të vlerave monetare të cilat në asnjë moment nuk mund të konsiderohen si kontribut në kapitalin e shoqërisë. Në momentin më të parë kur krijohet mundësia, shoqëria kthen huatë e marra nga ortakët.



Neni 7 Transferimi i kuotës apo pjesëve të saj

7.1 Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen/transferohen nëpërmjet:

- a. Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b. Shitblerjes;
- c. Trashëgimisë;
- d. Dhurimit;
- e. Cdo mënyrë tjetër të parashikuar nga ligji.

7.2 Kuotat e shoqërisë apo pjesë të saj (në vijim të quajtura kuota të shoqërisë) janë lirisht të transferueshme (blerje, shitje, dhurim apo çdo menyre tjetër që ndryshon pronësinë e kuotës) vetëm midis ortakëve të shoqërisë Evolutivo Albania shpk. Kufizimi për shitjen apo kalimin e kuotave, palëve të treta, nuk është i vlefshëm për ortakun themelues shoqërinë italiane Evolutivo srl (shpk). Ky përjashtim, prevalon mbi çdo parashikim të këtij statuti. Është vetëm në të drejtën e ortakut Evolutivo srl, nëse do të zbatohet në favor të ortakëve të tjerë të drejtën e parablerjes së kuotave.

7.3 Nëse ndonjë prej ortakëve të shoqërisë dëshiron të transferojë kuotën e tij, Ortakët e tjerë të shoqërisë gëzojnë të drejtën e parablerjes në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë statut dhe në ligj. Shitja e kuotës pa respektuar të drejtën e parablerjes së ortakëve të tjerë, është e pavlefshme/nul. Blerësi i kuotës nuk gëzon asnjë të drejtë mbi kuotën blerë dhe kësaj nuk gëzon asnjë prej të drejtave të ortakut në shoqëri.

7.4 Kuotat që zotërohen nga persona fizik, nuk janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Asambleja e Përgjithshme, vendos brenda 90 ditëve nga çelja e trashëgimisë, me jo më pak se 51% të votave të zotëruesve të kapitalit të shoqërisë, nëse kuota do të transferohet trashëgimtarëve të ortakut të vdekur apo trashëgimtarëve do të likujdohet kjo kuota. Asambleja e Përgjithshme në vendimin përkatës, përcakton edhe modalitetet e likujdimit të kuotës.

7.5 Kuotat nuk janë lirisht të transferueshme në rast ndarje/pjesëtimi pasuror midis bashkëshortëve si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve. Asambleja e Përgjithshme, vendos brenda 90 ditëve nga ndarja/pjesëtimi i pasurisë, me jo më pak se 51% të votave të zotëruesve të kapitalit të shoqërisë, nëse kuota do të lejohet të transferohet apo do të likujdohet përfituesve. Asambleja e Përgjithshme në vendimin përkatës, përcakton edhe modalitetet e likujdimit të kuotës.

7.6 Transferimi i kuotës pa respektuar vendimmarrjen e Asamblesë së Përgjithshme sipas parashikimeve të mësipërme është i pavlefshëm/nul dhe përfituesit nuk mund të ushtrojnë asnjë të drejtë në shoqëri.

7.7 Në rast se ortakun themelues shoqëria e të drejtës italiane Evolutivo srl (shpk), për çfarëdolloj arsyeje, priset apo pushon se ekzistuar sipas legjislacionit italian, kuota përkatëse u kalon menjëherë ortakëve të shoqërisë Evolutivo srl (shpk) në bashkëpronësi, sipas raporteve përkatëse. Këto të fundit, bëjnë marrëveshje për administrimin e përbashkët të kuotës apo pjesëtimin e saj.

7.8 Në rastin e parashikuar nga pika 7.8, nëse ortakët e shoqërisë italiane Evolutivo srl (shpk) shprehen me shkrim brenda 30 ditëve se nuk duan të jenë ortak në shoqërinë Evolutivo Albania shpk, kuota përkatëse u kalohet me kundërshtpërblim, sipas raporteve të përqindjes në kapitalin e shoqërisë ortakëve të tjerë që bien dakord. Vlera e kuotës përcaktohet si në rastin e likujdimit me kundërshtpërblim të saj.

7.9 Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata noteriale.

Neni 8

Çertifikatat e kuotave të kapitalit, largimi, përjashtimi dhe likuidimi i kuotës

8.1 Ortaku, në momentin e marrjes së pronësisë së kuotave të kapitalit, fiton të drejtën të marrë pa pagesë një çertifikatë për kuotën që zotëron. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një çertifikatë për kuotën në zotërim të përbashkët të disa personave dhe dhënia e çertifikatës përfaqësuesit të zotëruesve të përbashkët sipas Nenit 72, paragrafi (2) të Ligjit për shoqëritë tregtare, përbën një të dhënë të mjaftueshme për të gjithë këta zotërues. Emrat e zotëruesve të përbashkët renditen në çertifikatën e kuotës. Ky vërtetim nuk ka natyrën e letrës me vlerë.

8.2.1 Ortakët kanë të drejtën të largohen nga shoqëria nëse nuk kanë marrë pjesë në miratimin e vendimeve sipas parashikimeve statutore dhe legjisllacionit përkatës, si dhe nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.

8.2.2 Ortaku që dëshiron të largohet nga shoqëria duhet t'ia komunikojë këtë Administratorit të shoqërisë përmes një letre rekomande me njoftim-marrje ose nëpërmjet postës elektronike të certifikuar. Letra rekomande duhet të dërgohet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani për vendimin apo veprimin/mosveprimin që legjitimon kërkesën për tërheqjen nga shoqëria të ortakut. Tërheqja nga shoqëria konsiderohet e ushtruar ditën kur komunikimi ka arritur në selinë e shoqërisë.

8.2.3 Tërheqja nuk mund të ushtrohet dhe nëse është ushtruar është e pavlefshme, nëse shoqëria, revokon vendimin që e legjitimon kërkesën për tërheqje ose nëse është vendosur prishja e shoqërisë.

8.2.4 Administratori duhet të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dijani për njoftimin e largimit, për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme. Ky vendim i Asamblesë së Përgjithshme merret me jo më pak se 51% të votave të zotëruesve të kapitalit të shoqërisë.

8.3 Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë mund t'i kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim.

8.3.1. Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e ortakut, rastet kur ortakut:

- a) me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë;
- b) me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet ligjore;
- c) përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut;
- ç) me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë;
- d) drejton, administron, këshillon, themelon, punësohet ose bëhet ortak, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, të tërthortë apo të fshehtë pranë personave tregtar fizik apo juridik në çfarëdolloj forme qofshin ato.

8.3.2 Shoqëria ka të drejtë t'i kërkojë ortakut të përjashtuar shpërblimin e dëmit të pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përjashtimin e tij. Të gjitha të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqëri, shuhen në datën e largimit ose të vendimit të formës së prerë të gjykatës për largimin ose përjashtimin.

8.3.3 Ortaku nuk ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai përjashtohet për shkaqe të arsyeshme.

8.3.4 Ortaku shoqëria Evolutivo shpk, nuk mund të përjashtohet nga shoqëria për shkak të zhvillimit të veprimtarisë konkurruese me shoqërinë.

8.4 Në rastin ku shoqëria vendos likuidimin e kuotës, vlera e saj përcaktohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme duke marrë paraprakisht edhe mendimin e specializuar të ekspertit kontabël të autorizuar.

8.4.1 Likujdimi/pagesa e vlerës së kuotës apo pjesëve të saj duhet të kryhet brenda 6 muajve nga miratimi i vendimit të asamblesë.

8.4.2 Likujdimi mund të bëhet edhe përmes blerjes nga ortakët e tjerë në përpjesëtim me pjesëmarrjet e tyre ose si të bien dakord, apo nga një person i tretë i autorizuar nga Asambleja e Përgjithshme, të kuotës që do të likujdohet.

8.4.3 Nëse likujdimi sipas pikës 8.4.2 nuk arrihet, likujdimi bëhet duke përdorur rezervat e disponueshme ose në mungesë të tyre duke ulur kapitalin themeltar përkatësisht, me përjashtim të ndalesave ligjore.

8.4.4 Nëse nuk është e mundur likujdimi i kuotës, shoqëria mund të prishet sipas procedurave të parashikuara në këtë statut dhe legjislacionin përkatës.

Neni 9

Blerja/transferimi i kuotave nga ortakët dhe të tjerët

9.1 Ortakët e shoqërisë kanë përparësi për blerjen e kuotës apo pjesëve të saj, përpara personave të tretë jashtë shoqërisë. Ortaku që dëshiron të transferojë në afarëdolloj mënyre ose të shesë kuotat e tij tek ortakët e tjerë mund ta bëjë atë lirisht. Cmimi i kuotës që transferohet apo shitet përcaktohet me marrëveshje mes palëve.

9.2 Ortaku që dëshiron të transferojë ose shesë kuota tek të tretët duhet të ndjekë procedurën e parashikuar në këtë statut, përndryshe transferimi me afarëdo mënyre apo shitja e kuotës apo pjesëve të saj është e pvllefshme/nul dhe nuk passjell asnjë efekt për shoqërinë.

9.3 Ortaku që dëshiron të shesë ose të transferojë kuotën e tij apo pjesë të saj, duhet t'i njoftojë të gjithë aksionerët përmes letrave rekomande me njoftim marrje ose nëpërmjet lajmërimit me postë elektronike të çertifikuar dërguar në adresën e secilit prej tyre. Gjithashtu njoftohet edhe administratori i shoqërisë.

9.4 Njoftimi duhet të përmbajë të dhënat e plota të blerësit dhe kushtet e transferimit.

9.5 Ortakët që marrin njoftimet e sipërpërmendura kanë të drejtë të ushtrojnë të drejtën e përparësisë/parablerjes, për blerjen e kuotës apo pjesëve të saj, duke i dërguar ofertuesit deklaratën për ushtrimin e të drejtës së përparësisë/parablerjes përmes letrës rekomande me me njoftim marrje ose postës elektronike të çertifikuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit të ortakut për shitjen apo transferimin e kuotës apo pjesëve të saj.

9.6 Në rastin e ushtrimit të të drejtës së përparësisë/parablerjes nga më shumë se një ortak, kuota e ofruar do t'u kalojë ortakëve të interesuar në përpjesëtim me vlerën nominale të pjesëmarrjes që secili prej tyre zotëron në shoqëri.

9.7 Nëse dikush nga ortakët që gëzojnë të drejtën e përparësisë/parablerjes nuk e ushtron atë, e drejta përkatëse u kalon automatikisht dhe proporcionalisht atyre ortakëve që dëshirojnë ta ushtrojnë atë dhe që nuk e kanë refuzuar shprehimisht dhe paraprakisht në aktin e ushtrimit të të drejtës së përparësisë.

9.8 E drejta e përparësisë duhet të ushtrohet për çmimin dhe kushtet e përcaktuara nga shitësi apo transferuesi i kuotës.

9.9 Negociatat mes ortakëve duhet të përfundojnë brenda 60 ditëve nga njoftimi i fundit i ortakut që dëshiron të ushtroj të drejtën e parablerjes së kuotës.

9.10 Ortakët mund të kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes edhe për pjesë më të vogla të kuotës që kërkohet të transferohet, më të njëjtat kushte që ofrohen nga transferuesi, por në këtë rast duhet që transferuesi të bie dakord.

9.11 Nëse e drejta e përparësisë/parablerjes nuk ushtrohet brenda afateve të përcaktuara më sipër për kuotën e ofruar apo pjesë të saj, ortaku transferues, nëse nuk pranon ushtrimin e të drejtës së përparësisë/parablerjes për një pjesë më të vogël të kuotës së ofruar, do të jetë i lirë të transferojë të gjithë kuotën apo pjesën e destinuar në fillim për tu shitur apo tjetërsuar në çfarëdolloj mënyre, blerësit të përmendur në njoftim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit nga ortakët për mosushtrimin e të drejtës së parablerjes.

9.12 Nëse ortaku transferues, pranon ushtrimin e të drejtës së përparësisë për një pjesë të kuotës së ofruar, mund të transferojë atë pjesë të kuotës brenda të njëjtit afat të përcaktuar nga ortaku që ka ushtruar të drejtën e përparësisë dhe kushtet do të jenë të njëjta edhe me shitjen apo tjetërsimin e pjesës tjetër të kuotës përkundrejt personit tjetër jashtë ortakërsisë që kërkon të zotërojë kuotën apo pjesë të saj.

9.13 Nëse një ose më shumë ortakë dëshirojnë të transferojnë kuotat apo pjesë të tyre që përbëjnë më shumë se 51% të kapitalit të shoqërisë, ata duhet që për këtë rrethanë, të bëjnë me dije të gjithë ortakët që përfaqësojnë minorancën/pjesën tjetër të ortakëve si edhe administratorin e shoqërisë, duke dhënë të gjitha informacionet në lidhje me blerësin apo përfituesin e tretë, personin përfundimtar përfitues dhe çmimin e rënë dakord prapakisht.

9.14 Njoftimi do të kryhet përmes letrës rekomande me njoftim marrje ose me një mjet tjetër që garanton provën e marrjes, dërguar në adresat e përkatëse të ortakëve.

9.15 Në këtë njoftim, ortakëve të minorancës, duhet tu jepet e drejta e shitjes së pjesëmarrjes së tyre së bashku me shitjen e kuotave të shumicës, në të njëjtat kushte të përcaktuara për blerjen e pjesëmarrjes së shumicës dhe në favor të të njëjtit blerës/përfitues të tretë.

9.16 Kjo e drejtë duhet të ushtrohet nga ortaku ose ortakët e minorancës brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit të ortakut të shumicës, duke dërguar një letër rekomande me njoftim marrje ose me një mjet tjetër që garanton provën e marrjes.

9.17 Nëse një ose më shumë ortakë dëshirojnë të transferojnë kuotat e tyre që përbëjnë më shumë se 51% të kapitalit të shoqërisë, atyre u jepet drejta për të transferuar njëkohësisht me kuotat e tyre/shumicës dhe në të njëjtat kushte, edhe të gjitha kuotat e ortakëve që përfaqësojnë minorancën. Në këtë rast, ortakët e shumicës duhet të komunikojnë me ortakët e minorancës në lidhje me mënyrat e transferimit dhe çmimin e rënë dakord me blerësin e tretë përmes letrës rekomande me njoftim marrje ose me një mjet tjetër që garanton provën e marrjes.

9.16 Ortakët e minorancës kanë detyrimin të transferojnë tek i treti në të njëjtat kushte kuotat e tyre. Transferimi duhet të bëhet njëkohësisht me aktin e transferimit nga ortaku i shumicës (i cili duhet të ndodhë të paktën 30 (tridhjetë) ditë pune pas datës së dërgimit të njoftimit), pra, ortakët

e minorancës, kanë detyrimin të bëjnë gjithçka të nevojshme ose të dobishme për të garantuar një transferim të njëkohshëm dhe të unifikuar të kuotave.

19.17 Nëse çmimi i rënë dakord ndërmjet ortakut të shumicës së kuotave dhe blerësit të tretë është më i ulët se vlera e përcaktuar për rastin e likuidimit të kuotës për ortakun që largohet nga shoqëria, aksioneri i minorancës ka të drejtën e largimit nga shoqëria dhe të likuidimit të kuotës së tij.

19.18 Transferimet e kryera pa respektimin e dispozitave të këtij neni nuk kanë efekt ndaj shoqërisë, prandaj blerësi nuk ka të drejtën të regjistrohet në QKB, nuk është i autorizuar për të ushtruar të drejtën e votës dhe të drejtat e tjera administrative dhe nuk mund të shesë pjesëmarrjen me efekt ndaj shoqërisë.

19.19 Transferimi dhe shitja e kuotave, duhet të depozitohet në librin e ortakëve.

Neni 10 **Ndalimi i konkurrencës**

10.1 Ortakët e shoqërisë, si dhe administratorët e saj nuk mund të mbajnë një pozicion drejtues apo të zotërojnë kuota, aksione apo interesa të drejtëprdrete apo të tërthorta në shoqëri apo persona tregtarë të tjerë, që ushtrojnë veprimtari në të njëjtin sektor ekonomik me shoqërinë Evolutivo Albania shpk. Gjithashtu, këta persona nuk mund të mbajnë statusin e tregtarit për të ushtruar veprimtari në këtë sektor dhe as të jenë të punësuar apo të ofrojnë shërbime për persona të tretë që operojnë në të njëjtin sektor me shoqërinë Evolutivo Albania shpk.

10.2 Ndalimi i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni mund të shfuqizohet nëpërmjet një autorizimi të posaçëm, të dhënë nga asambleja e përgjithshme me tre të katërtat e votave, sipas dispozitave të neneve 87 apo 145 të ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

10.3 Ndalimi i përmendur në pikën 1 të këtij neni, do të mbetet në fuqi edhe pas humbjes së cilësive apo statusit të përmendur në të, por jo për një periudhë më të gjatë se një vit pas humbjes së kësaj cilësie.

10.4 Ortakët, me nënshkrimin e këtij Statuti, bien dakord që ndalimi i parashikuar në këtë nen të Statutit, të mos zbatohet për ortakun shoqëria italiane Evolutivo shpk.

10.5 Konstatimi, se ndonjë ortak tjetër përveç Evolutivo shpk, ka shkelur parashikimet e këtij neni, shkakton menjëherë largimin e ortakut nga shoqëria dhe anulimin e kuotës përkatëse pa të drejtën e tij për të kërkuar likuidimin e kuotës, si dhe legjitimon Shoqërinë të kërkojë shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga ortakut përkatës. Të drejtat e ortakut në lidhje me kuotën e anuluar shuhen menjëherë.

10.6 Shoqëria do të vijojë veprimtarine saj normale me kuotat e mbetura ndërsa pjesa e kuotës së anuluar u kalon në raport të drejtë ortakëve të tjerë sipas përqindjeve përkatëse në zotërimin e kapitalit të shoqërisë, pa kundërshtim.

10.7 Asambleja e Përgjithshme është organi i posaçëm që vlerëson rast pas rasti shkeljen e këtij neni, si dhe vendos sipas pikës 10.5 dhe 10.6 me jo më pak se 51% të votave të zotëruesve të kapitalit të shoqërisë.

10.8 Ndalimi i konkurrencës shtrihet si në territorin shqiptar ashtu edhe jashtë tij.

Neni 11 Organi Vendimmarrës

11.1 Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë.

11.2 Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

11.3 Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a. Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b. Ndryshimin e statutit;
- c. Emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d. Emërimin e shkarkimin e likujduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e. Përcaktimin e shpërblimit të personave të përcaktuar në pikën “c” dhe “d” të kësaj pike;
- f. Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h. Zmadhimin dhe zvoglimin e kapitalit;
- i. Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j. Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k. Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l. Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m. Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

11.4 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme në bazë të një autorizimi nga një person i tretë.

11.5 Administratori nuk mund të veprojë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme si përfaqësues i ortakëve.

11.6 Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.


Neni 12 Mënyra e thirrjes së mbledhjes së asamblesë

12.1 Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

12.2 Asambleja e përgjithshme thirret nga administratori apo ortaku sipas nenit 84 të ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

12.3 Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

12.4 Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.



12.5 Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

12.6 Në rastet e parashikuara në pikat 3 e 5 të këtij neni, asamblesë së përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar.

12.7 Dispozitat 12.4 dhe 12.5 të këtij neni nuk zbatohen nëse blerjet/shitjet, sipas pikave 4 e 5 të këtij neni, kryhen në bursë ose janë pjesë e veprimeve të përditshme të shoqërisë dhe bëhen në kushte normale tregu. Gjithashtu, këto dispozita nuk zbatohen në rastin kur shoqëria zotërohet nga një ortak i vetëm.

12.8 Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri në 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

12.9 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me e-mail nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes si dhe rendin e ditës dhe tu dërgohet të gjithë ortakëve jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

12.10 Mbledhja e asamblesë është e vlefshme edhe nëse zhvillohet plotësisht apo pjesërisht, me pjesëmarrjen e të gjithë apo disa ortakëve, edhe nëpërmjet sistemit të komunikimeve elektronike online me video (skype, teams, zoom etj). Vendimet e marra nëpërmjet komunikimit online, duhet të regjistrohen dhe mbahen në regjistrat dixhital të shoqërisë.

12.11 Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to:

a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale;

b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër;

c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.

12.12. Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.

12.13 Gjithashtu vendimet e marra nëpërmjet mbledhjeve të zhvilluara online si më sipër dhe procesverbali i mbledhjes shkruhen në letër nga administratori i shoqërisë apo personi i caktuar prej tij apo asamblesë, dhe nënshkruhen në një nga format e kërkuara nga legjislacioni shqiptar (nënshkrim fizik apo elektronik) dhe depozitohen në regjistrat përkatës të shoqërisë. Procesi i zbardhjes së mbledhjeve dhe nënshkrimit të akteve duhet të bëhet brenda 48 orëve nga përfundimi i mbledhjes me video online.

12.14 Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord për të marrë vendime pavarësisht parregullsisë.

Neni 13

Procesverbalet e mbledhjes së asamblesë

- 13.1 Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal.
- 13.2 Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryesuesit të mbledhjes dhe të mbajtësit të procesverbalit, si dhe rezultatet e votimit.
- 13.3 Kryesues i mbledhjes mund të jetë njëri prej ortakëve ose personi që ka thirrur mbledhjen, ndërsa mbajtësi i procesverbalit (sekretari) zgjidhet nga kryesuesi i mbledhjes.
- 13.4 Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si dhe akti i thirrjes se Asamblesë së Përgjithshme.
- 13.5 Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit. Ortakët mund të kërkojnë që procesverbali të nënshkruhet prej të gjithë ortakëve të pranishëm si edhe administratori nëse është i pranishëm.
- 13.6 Nëse shoqëria ka publikuar një faqe interneti, administratori jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes është i detyruar të publikojë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe.

Neni 14

Kuorumi

- 14.1 Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave.
- 14.2 Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje të cilat kërkojnë shumicë të cilësuar sipas nenit 87 të ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë apo mjete elektronike sipas pikës 3 të nenit 88 të ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.
- 14.3 Në rastet e tjera të parashikuara nga statuti, ku kërkohet miratimi nga ortakët që përfaqësojnë jo më pak se 51% të kuotave të shoqërisë, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm kur janë të pranishëm sipas përcaktimeve të këtij statuti, ortakët të cilët përfaqësojnë 51% ose më shumë të kapitalit të shoqërisë,
- 14.4 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lartë asambleja mbledhet përsëri me të njëjtin rend dite.

Neni 15

Marrja e vendimeve

- 15.1 Asambleja e përgjithshme vendos me jo më pak se $\frac{3}{4}$ e votave të zotëruesve të jo më pak se 51 % të kapitalit të shoqërisë, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 15.2 Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:
- a. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b. emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - c. emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

- d. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “b” dhe “c” të kësaj pike;
- e. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë se veprimtarisë;
- f. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

15.3 çdo ndryshim i statutit duhet të depozitohet në QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 16

Përfshirja nga e drejta e votës

16.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a. Vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b. Shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c. Ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- d. Dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

16.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtat kushte të konfliktit të interes ashtu si edhe ortaku të cilin përfaqëson.

Neni 17

Emërimi i administratorit

17.1 Asambleja e Përgjithshme emëron një person fizik si administrator të vetëm të shoqërisë.

17.2 Afati i emërimit është pesë vjet. Emërimi i administratorit i prodhon efektet nga momenti i regjistrimit në QKB.

17.3 Administratori është person fizik që mund të zgjidhet edhe jashtë bashkësisë së ortakëve të shoqërisë.

17.4 Në rast dorëheqje/shkarkimi Asambleja e Përgjithshme, jo më vonë se 2 javë nga moment i njoftimit të dorëheqjes ose shkarkimit emëron me vendim Administratorin e ri të shoqërisë.

17.5 Administratori i parë i shoqërisë do të jetë z. Neritan Zylyftari, shtetas shqiptar, i lindur në Berat më 19.04.1985, banues në Tiranë në adresën Rruga Bill Clinton, Pallati 14, Hyrja 1 identifikuar me dokumentin e kartës së identitetit me numër personal I50419078D;

Neni 18

Shkarkimi i Administratorit

18.1 Administratori shkarkohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

18.2 Do të konsiderohen shkaqe të përligjura të gjitha veprimet me faj të rëndë të Administratorit, paaftësia e tij në kryerjen korrekte të funksioneve, moszbatimi hapur i vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme, mosrespektimi i dispozitave të ligjit për shoqëritë tregtare dhe Statutit të shoqërisë, në përgjithësi çdo veprim i Administratorit, i cili dëmton ose mund të dëmtojë rëndë interesin e shoqërisë.

18.3. Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar asamblesë së përgjithshme. Administratori, që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh

rrethanat e veprimtarisë së shoqërisë, është gjithashtu i detyruar të thërrasë asamblesën e përgjithshme për emërimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën dorëheqja të hyjë në fuqi.

18.4 Nëse asambleja e përgjithshme nuk vendos emërimin e administratorit të ri në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga administratori i dorëhequr, atëherë administratori i njofton me shkrim dorëheqjen Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme dhe Qendra Kombëtare e Regjistrimit regjistron largimin e administratorit, sipas procedurave të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.

18.5 Dorëheqja e administratorit nuk cenon paditë e shoqërisë për shkelje të detyrimit të besnikërisë që administratori ka ndaj saj, sipas këtij ligji.

Neni 19

Kompetencat e Administratorit

19.1 Veprimtaria tregtare e shoqërisë menaxhohet nga Administratori, i cili mund t'i ushtrojë të gjitha kompetencat e shoqërisë që nuk i janë rezervuar Asamblesë së Përgjithshme nga legjislacioni në fuqi dhe ky statut.

19.2 Administratori ka këto të drejta dhe detyrime:

- a. Përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me të tretët;
- b. Kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politikën tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme përfshirë miratimin e planeve dhe llogarive ekonomike në përputhje me objektin e veprimtarisë;
- c. Miraton rregulloret përkatëse të punës, si dhe emëron e shkarkon punonjësit e shoqërisë;
- d. Merr me qira ambiente për shoqërinë si dhe mund të jap me qira ambientet e shoqërisë, me miratimin paraprak të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.
- e. Miraton pagat e punonjësve.
- f. Përcakton tarifat e shërbimit si dhe blen e shet në emër të shoqërisë pasuri të luajtshme, me miratimin paraprak të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.
- g. Për plotësimin e objektit të veprimtarisë së shoqërisë përveç angazhimit të punonjësve të saj, mund të angazhojë me kontrata shërbimi dhe punonjës të tjerë;
- h. Kujdeset për mbajtjen e sakte e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- i. Bën propozimet e nevojshme në mbledhjet e asamblesë nëse lind nevoja për të ndryshuar kapitalin themeltar.
- j. Miraton aktet dhe rregullat që rregullojnë punën e përditëshme të Shoqërisë, përfshirë menaxhimin dhe personelin.
- k. Përcaktimi i strukturës së menaxhimit të Shoqërisë.
- l. Krijon organe të tjera të nevojshme për realizimin e objektivave të Shoqërisë.
- m. Propozon krijimin e njërive, strukturave, degëve ose përfaqësive në qytete të tjera brenda ose jashtë territorit.
- n. Përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- o. Krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërkojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

- p. Kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për “Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- q. Raporton përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.

19.3 Shitja dhe/ose blerja e pasurive të paluajtshme do të konsiderohet e vlefshme nëse për të është marrë pëlqimi paraprak i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve. Në këtë rast vendimi përkatës i Asamblesë do të konsiderohet i vlefshëm, nëse ortakët që përfaqësojnë të paktën 51% të kapitalit të shoqërisë kanë votuar në favor të shitjes dhe/ose blerjes së pasurisë në fjalë.

19.4 Administratori përgjigjet për ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve të shoqërisë, duke përfshirë vendimet dhe procesverbalet e Asamblesë së Përgjithshme.

19.5 Administrator është i detyruar të thërrasë asamblenë e përgjithshme në rastet kur:

- a. Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk in mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim;
- b. Shoqëria propozon të shesë apo disponojë në mënyrë tjetër aktive të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% e aseteve të shoqërisë që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara;
- c. Shoqëria brenda dy viteve të para pas regjistrimit të saj propozon të blejë nga një ortak pasuri që kanë vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Neni 20

Shpërblimi i punës, përfitimet e tjera dhe shpenzimet e Administratorit

20.1 Administratori për punën e tij merr pagën përkatëse të përcaktuar nga asambleja.

20.2 Shpërblimit bazë të administratorit mund t'i bëhen shtesa, që mund të jenë përqindje në fitim ose të ngjashme. Shpërblimet e administratorit përcaktohen me vendim të zakonshëm të asamblesë së përgjithshme.

20.3 Shpërblimi, duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë.

20.4 Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e përgjithshme mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorit në masën e përshtatshme.

20.5 Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratorëve në strukturën e kostove të shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

Neni 21

Përgjegjësitë e administratorit

21.1 Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkeljet e ligjeve, të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

21.2 Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen për të përballuar në mënyrë individuale ose solidare sipas rastit pasojat përkatëse.

21.3 Përvec sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit për besnikëri sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të Ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, administratori detyrohet:

- a. Të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi duke i kushtuar vëmendje të vecantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b. Të ushtrojë kompetencat që i njeh ligji dhe statuti vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c. Të vlerësojë me përgjegjësi çështjet për të cilat merret vendim;
- d. Të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit të interesit prezent apo të mundshëm;
- e. Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e duhur.

21.4 Administratori gjatë kryerjes së detyrave të tij përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë, me përjashtim të rasteve kur në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

21.5 Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, është i detyruar të dëmshpërblejë dëmet ndaj shoqërisë si dhe të kalojë çdo përfitim personal që ai apo personat e lidhur me të kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave në mënyrë të rregullt e sipas standarteve profesionale.

21.6 Në mënyrë të vecantë por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar ti dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara nëse në kundërshtim me dispozitat e ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare kryen veprimet e mëposhtme:

- a. U kthen ortakëve kontributet;
- b. U paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c. U shpërndan aktivet shoqërisë;
- d. Lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare kur në bazë të gjendjes financiare duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- e. Jep kredi.

21.7 Përvec padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku kanë të drejtë të bëjnë kallëzim penal ndaj administratorit.

21.8 Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 22 **Viti financiar**

22.1 Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor.

22.2 Përjashtimisht viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 dhjetor.

22.3 Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, mbledhja e ortakëve miraton bilancin e paraqitur nga administratori.

22.4 Mbledhja e ortakëve vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, sic parashikohet nga ligji.

Neni 23
Ushtrimi i kontrollit nga ekspertët kontabël të autorizuar

- 23.1 Kontrolli i shoqërisë ushtrohet nga ekspert kontabël i autorizuar.
- 23.2 Eksperti kontabël i autorizuar emërohet për një vit financiar. Funkcionet e tij përfundojnë pas mbledhjes së asamblesë e cila merr vendim mbi llogaritë vjetore.
- 23.3 Eksperti kontabël i autorizuar, i emëruar nga asambleja për zëvendësimin e një tjetri, mbetet në funksion deri në fundin e mandatit të paraardhësit të tij.

Neni 24
Përgjegjësia e ekspertëve

- 24.1 Ekspertët kontabël të autorizuar janë përgjegjës si ndaj shoqërisë, ashtu dhe ndaj të tretëve për pasojat e dëmshme që rrjedhin nga fajet dhe nënvlerësimet e tyre në ushtrimin e funksioneve përkatëse.
- 24.2 Ata nuk janë ligjërisht përgjegjës për shkeljet e ligjit të kryera nga administratori, me përjashtim të rasteve kur kanë pasur dijeni për to, por nuk i kanë zbuluar në raportin për mbledhjen e asamblesë.

Neni 25
Shpërndarja e fitimeve

- 25.1 Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë.
- 25.2 Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

Neni 26
Kufizimet e shpërndarjeve

- 26.1 Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:
- a. Aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
 - b. Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.
- 26.2 Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e pikës 1 të këtij neni, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kriterë, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.
- 26.3 Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese.

Neni 27
Prishja e shoqërisë

- 27.1 Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar priset:
- a. kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
 - b. me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;

- c. në rast se objekti bëhet i perealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
- d. në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i këtij ligj;
- e. në raste të tjera, të parashikuara në statut;
- f. në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
- g. për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.

27.2 Prishja e shoqërisë, si pasojë e një apo më shumë prej shkaqeve të përcaktuara në shkronjat "a", "c", "e", "f" dhe "g", të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga asambleja e ortakëve me shumicën e parashikuar sipas pikës 1, të nenit 87, të këtij ligji.

27.3 Në rast mosveprimi të asamblesë së ortakëve për të vendosur prishjen, për shkaqet e përcaktuara në shkronjat "a", "c", "e", dhe "f", të pikës 1, të këtij neni, çdo person i interesuar mund, në çdo kohë, t'i drejtohet gjykatës për të konstatuar prishjen e shoqërisë.

27.4 Pavarësisht nga parashikimet e sipërpërmendura, ekzistenca e një a më shumë shkaqeve, të parashikuara nga shkronjat "a", "c", "e", "f" dhe "g", të pikës 1, të këtij neni, nuk do të ketë si pasojë prishjen e shoqërisë dhe hapjen e procedurave të likuidimit, nëse përpara vendimit gjyqësor të formës së prerë, të përmendur në pikën 3, të këtij neni, shkak i prishjes është korrigjuar, nëse është e mundshme të korrigjohet, dhe ky korrigjim është publikuar nga shoqëria në regjistrin tregtar, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.

27.5 Prishja e shoqërisë, si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente për procedurat e falimentimit, kur, në përfundim të këtyre procedurave, të gjitha pasuritë e shoqërisë janë likuiduar për shlyerjen në mënyrë kolektive të detyrimeve ndaj kreditorëve apo kur gjykata kompetente për procedurat e falimentimit vendos rrëzimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurisë së shoqërisë për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit.

27.6 Prishja e shoqërisë si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën "d", të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente, sipas parashikimeve të nenit 3/1 të këtij ligji.

Neni 28 **Likuidimi i shoqërisë**

28.1 Likuidimi i shoqërisë kryhet në përputhje dhe në respektim të kushteve dhe procedurave të parashikuara nga dispozitat përkatëse ligjore.

28.2 Prishja e shoqërisë, ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

28.3 Likuidimi kryhet nga likujduesit e emëruar nga ortakët. Nëse ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likujduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo njëri nga ortakët mund ti drejtohet gjykatës për të caktuar një likujdues.

28.4 Likujduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorit nga data e emërimit të tij. Tagrat e likujduesit u kundrejtohen të tretëve në përputhje me përcaktimet ligjore. Likujduesi i nënshtrohet mbikqyrjes së ortakëve dhe administratorëve.

Neni 29

Detyrat e likujduesit

29.1 Detyra e likujduesit është mbyllja e të gjithë veprimtarive të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas Kodit Civil.

29.2 Likujduesi mund të kryejë edhe veprime tregtare për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.

29.3 Nëse në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, likujduesi vëren se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e paashlyera, nuk është e nevojshme për pagesën e këtyre pretendimeve, ai detyrohet të pezullojë procedurën e likujdimit e ti kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

29.4 Likujduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në castin e hapjes së likujdimit dhe një bilanc përfundimtar në castin e mbylljes së këtyre procedurave.

29.5 Nëse procedura e likujdimit zgjat më shumë se një vit, likujduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqëri miratohen nga asambleja e përgjithshme.

Neni 30

Përfundimi i likujdimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura likujduesi njofton QKR, për përfundimin e likujdimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë në përputhje me seksionin V të L9723/2007 për qendrën kombëtare të regjistrimit.

Neni 31

Riorganizimi i shoqërisë, bashkimi-ndarja

31.1 Shoqëria mund të ndahet apo bashkohet sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të përcaktuara në ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

31.2 Shoqëria mund të bashkohet me një shoqëri tjetër nëpërmjet:

- a. Kalimit të të gjithë aktiveve dhe pasiveve të njërës ose më shumë shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, tek një shoqëri tjetër ekzistuese e quajtur përthithëse, në këmbim të kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim më përthithje.
- b. Themelimit të një shoqërie të re tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese që bashkohen në këmbim të kuotave të shoqërisë së re. Ky process quhet bashkim me krijimin e një shoqërie të re.

31.3 Shoqëria mund të ndahet me vendim të asamblesë së ortakëve duke transferuar të gjithë aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose më shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet vlerësohet e prishur. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216-225 të L9901/2008.

31.4 Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidarë për detyrimet e kësaj të fundit.

31.5 Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë QKR ka si pasojë:

- a. Kalimit shoqërisë pritëse të të gjithë aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet në përputhje me raportin e ndarjes të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive si dhe për palët e treta;



- b. Bërjen e ortakëve të shoqërisë që ndahet ortake të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;
- c. Vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga QKR, sipas seksionit V të L9723/2007.

31.6 Shoqëria mund të ndryshojë formën e vet ligjore nëpërmjet shëndërrimit të saj në shoqëri aksionare. Shëndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimit, që shoqëria ka ndaj të tretëve.

Neni 32

Dispozita të posaçme me afat

32.1 Ortakët që përfaqësojnë minorancën e kuotave të kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë që janë edhe ortakët themelues përsona fizik si vijon: 1. Neritan Zylyftari që zotëron një kuotë, që përbën 3% të kapitalit themeltar të shoqërisë; 2. Eleni Kullira që zotëron një kuotë, që përbën 2% të kapitalit themeltar të shoqërisë; 3. Denald Hushi që zotëron një kuotë, që përbën 2% të kapitalit themeltar të shoqërisë; duhet të përmbushin një periudhë 5-vjeçare në shoqërinë Evolutivo Albania shpk, si ortak dhe punonjës të saj si dhe të kontribuojnë me Know-how-n (dijet dhe lidhjet) e tyre në mbarëvajtjen e shoqërisë.

32.2 Përgjatë kësaj periudhe ortakët e sipërcituar nuk lejohet të shesin/transferojnë kuotat e tyre përveçse përkundrejt ortakut Evolutivo shpk.

32.3 Nëse Asambleja e Përgjithshme, përgjatë periudhës 5-vjeçare të parashikuar në këtë nen, nëpërmjet votimit të ortakëve që zotërojnë jo më pak se 51% të të kapitalit të shoqërisë, vlerëson dhe miraton, faktin se ortakët apo ndonjë prej ortakëve të përcaktuar në pikën 32.4 të këtij neni, gjenden në shkelje të parashikimeve të mësipërme dhe atyre të parashikuara në këtë statut, si ortak apo si punonjës, Asambleja mund të vendos anulimin e kuotës së ortakut apo ortakëve të gjetur në shkelje pa të drejtën e likujdimin të kuotave respektive.

32.5 Shoqëria do të vijojë veprimtarinë e saj normale me kuotat e mbetura ndërsa kuota e anuluar i kalon pa kundërshpërblim ortakut Evolutivo srl (shpk).

Neni 33

Dispozita të përgjithshme

33.1 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me legjislacionin dhe këtë statut.

33.2 Për të gjitha çështjet për të cilat Statuti nuk i parashikon ose nuk i rregullon në mënyrë të posaçme do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

33.3 Shoqëria tregtare Evolutivo Albania shpk e fiton personalitetin juridik me regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

32.4 Ky statut me ndryshimet dhe dokumentet e tjera, raportet, komunikimet dhe procesverbalet e dorëzuara nga Shoqëria do të regjistrohen në një regjistër protokolli në selinë e Shoqërisë.

Neni 34

Mosmarrëveshjet

Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lind midis shoqërisë dhe të tretëve, nëse palët nuk e zgjidhin me mirëkuptim, kompetente do të jenë gjykatat shqiptare.

Neni 35
Dispozita përfundimtare

35.1 Ky Statut përpilohet në 2 (dy) ekzemplarë origjinalë dhe nënshkruhet në çdo fletë të tij nga themeluesit/ortakët e shoqërisë. Të dy ekzemplarët janë me vlerë të njëjtë ligjore, të hartuar në gjuhën shqipe dhe njëri prej të cilëve do të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Gjithashtu, përderisa njëri prej ortakëve themelues është shoqëri e të drejtës italiane, statuti i shoqërisë përkthehet nga përkthyes të licensuar të gjuhës Italiane, nënshkruhet prej të gjithë ortakëve edhe ky ekzemplar në gjuhën italiane, noterizohet si dhe depozitohet në shoqëri edhe në këtë gjuhë.

35.2 Ky Statut do të hyjë në fuqi menjëherë.

35.3 Administratori i shoqërisë autorizohet të kryejë aplikimin pranë QKR për regjistrimin fillestar të shoqërisë tregtare Evolutivo Albania shpk.


ORTAKËT THEMELUES

TË SHOQËRISË “EVOLUTIVO ALBANIA” SH.P.K

Ortaku

DAVID ANTONI CASTIONI

Evolutivo srl



Ortaku

Neritan Zylyftari

Neritan Zylyftari



Ortaku

Eleni Kullira

Eleni Kullira



Ortaku

Denald Hushi

Denald Hushi

